

ODISE KOTE

**AGONIA**

roman

---

BOTIMET TOENA



**ODISE KOTE**

AGONIA

roman

**BOTIMET TOENA**

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Arben Bllaci

Korrektore letrare: Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817433

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al/>

... kur marrëzia e çmend dhe e nxjerr shtetin në treg, kur Paraja kapërcen të gjitha limitet e ligjit e moralit, shëndeti mendor i një shoqërie gremiset në fund të honit, në fundajën e errët, ku vesi dhe papjekuria kulturore ndihen në triumfin grotesk të një çlirimi pa cak dhe zëri i arsyes, i ndërgjegjes e i së vërtetës, bëhet gjithnjë e më i dobët, për jetën dhe për botën...



Ishte ngjitur gjer në re, në qiell, mbi male. Kishte dhënë fjalën të takonte legendën e Shkëmbit të Nuseve. Duhej të ishte jo fort në rregull nga trutë të takojë një legjendë, aq më pak, gjarprin e zi.

Fjalën ia kishte dhënë stërgjyshit, Nikolla Kostanit, mjeshtërok i njohur, ndërtues shtëpish e rrugësh në Ballkanin Juglindor, i cili në fund të jetës u transferua në Tiranë që të rehatohej. “*Jeep*”-i i lartë, katërvendësh, nëpër një rrugë të paasfaltuar, mbërriti fillimisht në Kamenckë, fshat i vogël që ngrihej përanash rrafshpallajës me bimësi të harlisur.

Bredhat e stërvjetër, pishat e larta që thujse preknin retë me degë, ishin ku e ku më lart. Aty më sipër nderej shtroja e dëborës. Dielli dimëror shkëlqente me gjithë dritën e tij, thyhej mbi grimcat kristal të dëborës dhe shpërndante miliarda vezullime pasqyrëzash që të merrnin sytë.

Kishin ecur në një rruginë të ngushtë, thujse sa gishti i dorës. Rruginë me kalldrëm gurë - hi e kohës së Arbrit, që dukej se s’do të mbaronte kurrë.

“Mbase në këta gurë - hi shket dhe legjenda e gjarprit të zi”, shkrepri befas pandehma në kokën e Bojken Kostanit.

Verbimi prej saj ia ktheu kryet djathtas, ku shfaqej i frikshëm një kanion që sikur rrokullisej nga qielli derisa përplasej në tokë. Mu në mes të kanionit ujëkristal, ngrihej një gadishull shkëmbor me lartësi rreth treqind e dyzet këmbë, me gjatësi pesëdhjetë e pesë këmbë dhe gjerësi

katër këmbë e gjysmë. Sikur ishte ngulur gjithë zemërim drejt e në tokë.

E quanin Shkëmbi i Nuses. Qëndronte aty i palëvizur, brengëcopëtuar, ngjizur gur mbase që kur kishte zënë fill bota.

“O udhëtar, pyetmë përse jam ngulur kështu në tokë! Përse nuk çlirohem dot nga barra e brengës? Pyetmë për nusen e legjendës... Ngrirjen e krushqve. Edhe për hingëllimën ngjethëse të kalit, për krifën e tij të përgjakur. Pyetmë!”

Kështu dukej sikur thoshte guri.

Kaq e madhe mahnitja, sa syri i njeriut nuk ngopej duke kundruar. Lodhej e dorëzohej. Në krah, bimësia, një rrëmujë e ushqyer me burime të nëndheshme, kushedi se ku uturinte e gjëmonte.

- Ku janë shqiponjat që premtove? Ti më ke thënë se rinë në shpatull të njeriut, - lëshoi piskamë lodhjeje Keti Braumfisher, fotografja gjermane, që, megjithatë, nuk e fshihte dot shtangien e mahnitjen.

- Ah, gjeti kohën... - fshehu pakënaqësinë Bojken Kostani.

Në kokë i trokiste pa pushim legjenda. Pesha e saj. Herë i shfaqej e pavërtetë, ëndërr, herë merrte trajta të plota, të pazbërthyeshme.

“A thua është gurëzuar? Futur e tëra në shkëmb? Si do ta nxjerr prej andej?”

- Më trego! - ngulmoi gjermania, aspak si gjermane me ata flokë të zinj si korb e me sytë bojë qielli.

E kishte pikasur mëdyshjen në muskujt e fytyrës së tij.

## *Agonia*

- Legjenda, ti e di, është atje, në majë, atje ku zë shtresë të trashë dëbora... - foli zëulët Bojkeni, sikur të mos donte që pemët rrotull të dëgjonin shpjegimet e tij. - Legjenda shikon diellin, ngrohet në diell, dritësohet me diell... Më kupton? Pastaj grimcohet për hapësirën qiellore, si edhe yjet që nuk i arrin dot njeriu.

- Ashtu? - bëri sikur shfaqti kërshtëri Keti.

Bojken Kostani deshi ta ndërpriste. Ç' ishte ky delir? Por iu duk e arsyeshme të priste. E dinte, sado interesante të ishin shpjegimet e tij, në fund të ditës, ashtu si dritësimi, ato do të fikeshin. Ata do të ktheheshin në hotelin ndanë lumit Vjosë, në qytetin e vogël Përmet.

- Megjithatë, sipas rrëfenjës, - nuk donte të ngutej Bojken Kostani, ndaj e shqiptoi ngadalë, krejt kthjelltas mitin, - pasi vdiq njeriu i parë i këtyre anëve, e varrosën këtu, në këtë tokë. Për nderim të tij, njerëzit e fisit lëshuan në fluturim një shqiponjë. Ata shpresonin se kështu shpirti i të vdekurit do të mbërrinte më shpejt te Zoti.

- Ah...

Pas këtij pohimi, trazimi në sytë e Keti Braumfisherit ngjau me fluturimin e fantazmës.

## KAPITULLI I

Bojken Kostani dhe Ketii Braumfisher fluturuan nga aeroporti “Konrad - Adenauer” i Këlnit për në Milano dhe fill më pas, në linjën Milano-Rinas, Tiranë, më 24 dhjetor 1996. Të nesërmen, më 25 dhjetor, udhëtuan herët për në Përmet, në kërkim të një legjende. Një aventurë e kërkuar prej kohësh.

E kishin planifikuar më parë udhëtimin dhe mezi prisnin ta shijonin. Leja e Ketit ishte vetëm katërditore, me biletë vajtje-ardhje. Duhej të kthehej sërish në punë, në projektet e planifikuara. Ishte fotografe profesioniste. Kompania e saj i kishte studiot qendrore në Bon.

Bojkani kishte tjetër histori. Nuk ishte thjesht një i arratisur në korrik të 1990-s, nga ambasada gjermane si emigrant politik. Fati e kishte ndihur të përfundonte studimet për letërsi të krahasuar në Bon, njëherësh të punonte gazetar i lirë. Fillimisht gazetar kronike, më pas iu besuan komentet, opinionet, editorialet. Intuita e fortë, zhërvjelltësia, procedimi i saktë, sidomos racionaliteti e paanësia ishin armët e suksesit të tij. Gazetar i ftohtë, këmbëngulës, i mprehtë, punëmbarruar. Në trurin e tij nuk kishte trazim, hutim, halucinacion, errësim të ndërgjegjes, gjë që ishte e vështirë të shmangej.

Shpesh e dërgonin me shërbime speciale. Tashmë ishte përcaktuar prej shumëkombëshes mediatike si drejtues i

redaksisë në Tiranë. Bojken Kostani niste një punë të re në kryeqytet, ndërsa e dashura e tij, Keti Braumfisher niste një aventurë që as nuk ia dinte fillin.

Bojken Kostani, krahas gazetarisë, pasion të madh kishte edhe gjurmimin e miteve e legjendave.

“Ç’ të duhet gazetaria? Merru me studime”, e këshillonte shpesh e pa qëllim Keti, që sikur i jepte një paralajmërim të çuditshëm.

Bojkeni ikte shpesh gjer në fund të botës, hynte nëpër biblioteka, takonte çdo dëshmitar që përgjigjej, çdo studiues për shkodimet, dekritimin e shkrimeve katalehe, gjetjen e shpjegimeve të besueshme për kërkimet e tij. Fotografonte e mbante shënime pareshtur. Nuk besonte kollaj. Huqet e gazetarit të rafinuar, intuita, syri i mprehtë dhe shpejtësia e procedimit të saktë mbi lëndën e përzgjedhur, u bënë natyra e tij e përditshme. Çantën me magnetofonin e aparatit fotografik nuk i ndante nga supi.

“Ëndrrat e mia janë një shaka mizore, - i thoshte ndonjëherë vetes, - më tallin shpesh.”

Rrallë, shumë rrallë vinte në Shqipëri. Më shumë për të takuar nënën dhe motrën e vetme, studente në Fakultetin Juridik. Aso kohe punonte për shumë redaksi në të njëjtën kohë. Bojkeni s’kishte takime të errëta me fatin. E shkuara e afërt po i jepte forma të çuditshme jetës së tij.

Kishte ardhur kësaj here në Shqipëri me mikeshën e tij fotografe, Keti Braumfisherin, që të festonte, sipas shijes së saj, Krishtlindjen. Por edhe të niste gjurmimin e legjendës së Shkëmbit të Nuses dhe gjarprit të zi. Legjenda kishte për truall zonën e sipërme, mal e qiell, midis Hotovës, Frashërit e Koblarës, në Juglindje të vendit.

Bojkeni dhe Ketu, atë dhjetor ishin dy të dashuruar që deshën një Krishtlindje ndryshe, me një festë të vogël modeste, të mëvetshme, krejt të tyren.

Shkarkuan bagazhet në hotel, zunë dhomën që binte gati mbi lumë, porositën darkën dhe u nisën drejt legjendës. “Jeep”-i ishte makinë e përshtatshme për atë rrugë. Pas disa kthesave të forta, u ngjitën në mal.

Ishte paradite e zymtë, ngarkuar me ajër të ftohtë. Kohë e thatë, koprrace. Ndihej menjëherë ikja e vjeshtës. Megjithatë, në bimësinë e harlisur dëgjoheshin ende turtulli, gardalina, mëllenja, qukapiku i drurit, qyqja, gushëkuqi... Bojkeni hasi diku edhe kalin e qyqes. Kali i qyqes ishte zhdukur ca kohë, por qe kthyer sërish në ato maja që sikur gjithë ditën flisnin me perënditë. Nuk ishte stina e gjetheve, prej andej shihej lumi që vraponte si gjarpër i zi, duke rrahur me ujëra brigjet, duke i shtyrë në heshtje, tallaz-tallaz me rrymat e tij.

Ketu Braumfisher nuk ngopej me ajër dhe foto. Megjithëse dhjetor, aroma e pyllit, e pemëve dhe e shkurreve ndihej që larg, e gjallë, përtëritëse. E lanë “Jeep”-in diku, midis ca ferrave e gëmushave dhe ecën më këmbë për gati një orë. Kërkonin burrin e shënjuar, më të vjetrin e Kamenckës, Kostandin Ballgjerin.

Pyetën e pyetën, shteg më shteg, më në fund e gjetën. Ca e ca, asaj ane e thërrisnin “magjistari i legjendës”. Të tjerë, krejt në të kundërt, “varrmihës i legjendës”. Disa fshatarë të tjerë që hasën rrugës, ngarkuar mushkat me dru dimri, tundnin kokën:

“Përse humbni kohë kot! Ai është djall!”.

E gjetën pas mundimeve të mëdha. Bënte dru në pyll.

Një sëpatë të madhe në duar, një të vogël në brez. Folën me të, por nuk e morën vesh nëse e bindën apo jo, për t'iu rrëfyer fillin e legjendës. S'dukej se qe në ditën e duhur për të rrëfyer. E intervistuan ashtu ulur, mbi një trung të prerë dushku. Fliste kuturu. Me fjalë fluturake si gjethet që i rrëmben era, pa ditur ku i shpie. I kërkuan t'iu tregonte detaje, t'i shpinte nëpër ato vendet e shenjta, të fshehta të legjendës, aty ku askush nuk kishte shkuar gjer atëherë... Por ai tundi kokën.

- Jo, jo. Jo kaq shpejt. Duhet të vini në një kohë tjetër...

- Kur është ajo koha tjetër? - nguli këmbë Bojkeni, që ishte gati të ngjitej, të zbriste, të lodhej pas gjurmëve të legjendës.

E dinte se, kur të ndalej, do të kishte përpara fytyrën e nuses, të kalit, dihatjen e tyre para shkëmbit, trokthin e penguar, devijimin drejt greminës, pendesën, atë ngjyrën e murrme të brerjes së ndërgjegjes, dhëndrin e lemerisur, padurimin e fluturimit, lajmësit e rremë, vajtojcat e fshatit, erën dhe gjethet e pemëve. E dinte...

“Kështu ka për të ndodhur, nëse arrij. Po unë paskam qëndruar në vend duke pritur!”

- Ik tani! - e përmendi Kostandini që e ndjeu në zë se dëbimi ishte diçka e rreme, pa kuptim.

- Ku të iki? Kam pritur kaq kohë të të gjeja. Gjer këtu në majë, u ngjita vetëm për ty. Më në fund të gjeta...

Bojkeni e ndjeu se nuk ishte ora e tij me fat. Duke këmbëngulur e duke i ardhur rrotull, legjendëmbajtësi mund ta shpinte andej nga ku nuk duhej të shkonte kurrë.

- Ik, se do të bjerë nata, dhe nata këtu është e keqe. Dalin ujqër e çakej. Dalin dhe derra të egër. Të shqyejnë po të mos dish nga të shkosh. Ik...

- Po ty nuk të shqyejnë?

“Burrë i marrë”, deshi t’i thoshte.

- Jooo, jo, jo. Unë jam njeriu i pyllit. Jam njëri ndër to...

Kostandin Ballgjeri lëshoi një gulç ngjethës si të ishte shndërruar vërtet në kafshë e natyralizuar. Dhe kishte të drejtë. Siluetën e zbehtë të diellit mbështjellë me mjegull e kishte pas. Një diell që po perëndonte shpejt, krejt i drobitur dhe pa fuqi për t’ia lënë vendin muzgut të zymtë, mbushur me njolla e re të zeza ulur gati mbi majë.

Bojken Kostani nuk e kuptoi as vetë pse i besoi fjalës së tij. Mbase duke ikur hija do ta ndiqte pas. Dhe dukej se do t’i thoshte:

“Kot e ke, do të të mbërthej kudo që të vesh. Nuk e nise mirë. More dhe një të huaj me vete. A jepet kështu një legjendë?”

Fluturoi nëpër shtegun që gjarpëronte nëpër ca brinja poshtë e më poshtë, në krah të kanionit të stërmadh, si një hinkë gjigante, ndërsa muzgu, ngadalshëm nisi të mbështjellë me ajër të freskët shiu e suferine, pemët, hijet dhe fantazmat.

\* \* \*

Shija e hidhur e atij udhëtimi absurd, moskuptues, u shua përnjëherë kur recepsionisti, një burrë plak, syzhgabonjë i la në dorë pusullën me shënimin:

“Ejani në dasmë, te vila në Bolëngë. Jeni të ftuarit e mi!”

Pronari i hotelit qeraste klientët e pakët në vigjilje të Krishtlindjes. Asnjëherë nuk e kishte kuptuar përse pas një zhgënjimi, në kundërti me të, nxirrte krye një ofertë e re, mikluese, me mundësi kënaqësie.

I tregoi Ketit për ftesën e pronarit dhe ajo përplasi duart me zellin e vajzës mirënjohëse kur i ofrohet një dhuratë Krishtlindjesh. Më shumë se dhuratë, Bojkeni qe i bindur se ai ishte ngazëllim vajze të dashuruar. Qepallat iu pulitën lehtë si krahë dallëndyshesh dhe ai, kushedi përse, mendoj si do ta perceptonte ajo një dasmë përmetare, a do të mbetej e kënaqur. Përse e ndolli këtë vjegë?

Receptionisti, sikur të dinte ç'kishte në kokë gazetari me të dashurën e huaj, siç i kishte regjistruar në regjistër, foli me zë të ulët:

- Ju shpie unë gjer te vila.

- Ashtu?

- Nisemi në orën tetë. Dhjetë minuta mban me këmbë prej këtu, - saktësoi receptionisti duke i mbyllur të gjitha dritaret e hezitimit.

- Do të ishte fantastike. Faleminderit!

U ngjitën gati me vrap në kat të dytë, hynë në dhomë, hoqën me nxitim teshat, pastaj në dush, duke i pëshpëritur njëri-tjetrit herë shqip, herë gjermanisht, fjalë që vetëm ata i dinin. Laheshin duke fërkuar shpinën, fundin e barkut, gushën dhe... Nuk fshihnin asgjë. Putheshin dhe në fund të dihatjes, si të ishin marrë vesh kushedi në ç'thellësira, brendësia lëshonte fjalën: sublime!

- A e di? - mërmëriti Bojkeni ashtu, përhumbar në ngasje e ngopje kënaqësie. - Thuhet se amvisat holandeze janë nga më të pastrat në botë. Po të siguroj që përmetaret ua kalojnë.

- Ha-ha-ha, i keq! Ç'ishte kjo? - qeshi me të madhe Keti Braumfisher, që besoi se atë minutë Bojkeni deshi të bënte burrin misterioz.

Vërtet ishte burrë misterioz?

Ai nuk u përgjigj menjëherë. I shkoi dorën në flokët e lagur që lëshonin aroma trëndafilash, e futi, si për ta mbrojtur, të tërën mes krahëve dhe i pëshpëriti butësisht:

- Do t'i shohësh vetë se si janë...

- Si?

Keti Braumfisher ndjeu se diç e rrezikshme, mbase, pa formë të caktuar, vetëtiu në mendjen e Bojkenit. Ç'të ishte ajo?

Ajo që vetëtiu në mendjen e tij, e zbërthyeshme lehtësisht, ishte përcaktimi brilant që prifti famëmadh, Noli, e kishte thënë fare thjesht vite me parë.

“Do të hash e të bësh qejf,  
sofrën shtruar si për mbret,  
pastërtore e për hyzmet,  
të tillë gjen veç në Përmet.”

Megjithëse qytet i vogël, emrin e ka të madh, aty i gjen të gjitha. Sofrën e mbushur plot, butet me verë dhe vashëzat si drita...

Po si ta kuptonte këtë Keti Braumfisher? Ajo ndjeu se pak e pak ai po bëhej zotërues dhe u ndje në ankth. E kuptueshme. Mos vallë diçka vërtitej në erë dhe ajo ishte me vonesë për ta kapur? Nuk dëshironte që kur të shkonin atje, në atë dasmën përmetare që kishte rrëmbyer mendjen e Bojkenit, ajo të mbetej vetëm. “Se vetëm jam dhe kur jemi bashkë...” - ish-in vargjet e një kënge që se ku e kish dëgjuar. Jemi shumë të rinj dhe në kujtesën tonë do të regjistrohen shumë gjëra, ndodhi, ngjarje, takime, thyerje shpirti, flirte e dashuri të pakryera. Janë ca ndërhyrje, ca ligje të fshehta, ca vibrime të holla, që, kur kapërcejnë zonën e ndaluar, të shpien në kalime të kundërnatyrshme. Dhe ndodh ftohja e

tmerrshme, gjer në tharje. Po kjo s'mund të ndodhte me Bojken Kostanin. S'mund!

- Nuk më ke thënë asgjë për qytetin...

Keti Braumfisher deshi t'i kujtonte Bojkenit se ishte grua që nuk rrëzohej në zgripe. E trembur disi me veten, ajo dukej atë çast mrekullisht joshëse. Ndryshe nga ca minuta më parë, zëri i rrëmbeu sërish timbrin gazmor, ndonëse në mendje nuk i ndahej përcaktimi "i rrezikshëm". Në vend të alarmit, në tipare iu përvijua një qetësi e papritur.

- Atje ku do të shkojmë, në majë, janë rrënojat e një manastiri. Vendi duket si vendbanim i ndonjë shenjtori të harruar...

Fjalët e Bojkenit sikur vinin nga një mjegull paqeje.

- Vërtet?

- Ka qiparisa të lartë, dushqe të purpurt dhe në pranverë gjelbërimi të çmend.

I shkreti burrë mezi po e përballonte valën e mallëngjimit, haptas po i rrëfente asaj se ishte zonë që ai e njihte në hollësitë më të vogla.

- Ti ke qenë herë të tjera aty?

Dyshimet e saj dukeshin tronditëse. Kushedi ç' histori të rrejshme, "ashtu kot", nisi të bluante në mendje. Bojkeni asnjëherë nuk i kishte folur për Përmetin. Emri i qytetit mbiu midis, kur ai e ftoi Keti Braumfisherin të shkonin në kërkim të legjendës të Shkëmbit të Nuses dhe gjarprit të zi. Po edhe për të krentuar Krishtlindjen.

"Kaq për zemër e paska pasur? Apo në këtë qytet ai fsheh diçka? Një flirt mbase, një kujtim, një dashuri të vjetër?"

Kishte ende një orë kohë, derisa në derën e dhomës të trokiste recepsionisti syzhgabonjë që do t'i shoqëronte për

atje, në atë dasmën përmetare. Çudi! Keti Braumfisherit qysh në fillim iu krijua bindja se receptionisti e njihte Bojkenin. Pas informacioneve të detajuara imtësisht, përshtypja e parë iu kthye në bindje.

“Le të jetë ç’të dojë, - mendoj, - tani Bojken Kostani është imi! Imi dhe i askujt tjetër!”

- Po, - u përgjigj shkurt Bojkeni. - Kam lexuar shënime të ndryshme udhëtarësh të shquar për Përmetin.

Përgjigjja iu duk e mjegullt. E përgjithshme.

“Po si mund të jesh kaq naiv, o njeri! Unë dua të më duash, jo të më shpjegosh”, klithte shpirti i saj.

- Përmeti është i pastër, i ndërtuar mirë, i vendosur vërtet shumë bukur, buzë Vjosës ngjyrë kuaz...

Sytë e tij po e vështronin ngulshëm.

- Do ta shohësh nesër në mëngjes lumin si vërsulet nëpër një hon që e ka çarë vetë në tokën e butë.

- Lumin e dashke shumë...

Pohimi nuk mjaftoi për të mposhtur tingujt ligështues, të mekur që artikuluan buzët e saj.

- Ja, këtu poshtë dritares, në anëllumi. E shikon? Ngrihet si vigan një shkëmb këputur nga mali. Në rrëzë të tij ka burim me ujë të bekuar...

Ngazëllimi i kaloi në shfrim, klithje, sikur donte t’i binte kamberës:

“Nuk i sheh këto mrekulli?”.

- Oh, interesante! Dhe ku buron ky lumë? - përmbylli grackën ku rrezikonte të binte Keti Braumfisher.

“O Zot, mos ardh të dita që të them gjëra pa kuptim, për të fshehur diç tjetër!”, mendoj ajo, si t’i ikte një kurthi, pak a shumë një robërie.

- Lumi buron matanë kufirit, jo shumë larg, në malet e Pindit dhe rrjedh nëpër tokën shqiptare, derisa derdhet në det, - shqiptoi Bojkeni frazën standarde që as e mendoj, por ia nisi Ketit që ngjante fare e panatyrshme.

“Budalla, - iu kthye vetes. - Gjete kohën për t’i vizatuar pamjet me detaje, për të treguar bukuritë e Përmetit. E di ti se për të rrëfyer të plotë tekstin ‘Zemra e liqerit’, të Lasgush Poradecit, duhet një javë kohë?”

Më në fund e kuptoi që biseda e tyre kishte ngecur, kishte rrëshqitur në ujëra vanitoze, qe gremisur në hon. Nuk e dinte që nga honi vijnë ndonjëherë përfitimet e paqes. Njeriu përton të zbresë, pastaj të ngjitet sipër për të shkuar te tjetri. Në vend të grindjes, kacafytjes, dëshirës për të shestuar keqkuptimin, atij i mbërriti e kundërta.

Dëshira për përkëdhelje, për përqaftim, për shkrehje në dashuri...

\* \* \*

Taksia rozë ishte parkuar përpara hotelit.

- Ç’është kjo taksi?

Askush nuk foli, as u habit nga një taksi parkuar para hotelit. Ishte më e natyrshme gjë që mund të shihje.

Receptionisti mbështolli qafën me shall dhe bashkë me dy mysafirët, Keti Braumfisher dhe Bojken Kostani vijuan rrugën sipër, për në vilën me gurë të zinj, midis qiparisave, bredhave e pishave të Bolëngës.

Vila gjendej gati rrzë malit. Rrotull kishte ndërtesa të ngjashme, të gjitha ishin bërthama e lagjes “Shënkoll” me gjurmë të vjetra, porta me hark dhe selvi shumëvjeçare.

Dy kisha, e Shën Premtes, shekulli i shtatëmbëdhjetë dhe e Shën Kollit një shekull më pas, ngriheshin përballë njëra-tjetrës. Ndriçimi i pakët, i zbehtë si nga anemia u kishte dhënë ngrehinave shijen e vjetrimt të ngadaltë. Mes tyre zgjateshin rrugë të shtruara më së shumti me kalldrëm, me gurë gëlqerorë e gurë lumi. Teknika e shtrimit ishte e njohur, si ratë dhe si këlliç. Në çdo shtrirje rrugore kishte një linjë qendrore për ujërat e përditshëm që dilnin nga mullinjtë dhe pastronin rrugët, portat dhe kopshtet.

Shtëpitë ishin thujse ngjitur njëra-tjetrën, me oborre e kopshte të vogla, me pjerrësi të lehtë imponuar nga terreni. Rrethimet e avllive vinin të mbyllura nga mure të larta dhe porta druri me strehë. Shumica e shtëpive në Bolëngë janë dykatëshe, me mur guri dhe çati me rrasë po ashtu guri, por ka dhe vilat trekatëshe.

Vila e dasmës ishte me bashtinë të madhe, shtrihej nën këmbët e bregores së Bolëngës, përfund së cilës ndodhej kalaja. Dukej mbi të tjerat, mbizotëronte dhe kishte hapësirë pamjeje të gjerë. Portat ishin hapur, dykanatëshe.

Dasma kishte nisur kur Bojken Kostani dhe Keti Braumfisher hynë në patin e vilës e më pas u ngjitën shkallëve të katit të dytë, në sallën e mesit, si nja tridhjetë metra e gjatë. Aty qe shtruar darka. Salla e mesit ishte princërore, derdhur në dru të gdhendur, me shandanë të varur, dy radhë të gjata shtrojash druri, rruginë midis, servise të shtrenjta, qelqe, bufë e në fund një hapësirë si nja dhjetë metra lënë bosh për kërcime.

Bojkeni dhe Keti zunë vendet e caktuara. Pranë tyre u ul pronari i hotelit me gruan. Pas pak ai u ngrit për të vënë rregull në dasmë. Gruaja, një trashaluqe e lezetshme,

faqekuqe, naive symëshqerrë që s'i pushonte goja, iu ngjit Ketit pa ditur se ishte e huaj. Një minutë më vonë, i pëshpëriti se burri i saj qenkësh xhaxhai i dhëndrit.

- Dhëndri erdhi para një jave nga Australia, - nuk pushonte trashaluoja. - Erdhi të marrë nuse në Përmet. Na kishte shkruar letër, po ne nuk e besuam. E kam amanet nga babai, thoshte. Babai i tij ka njëzet e tre vjet vdekur. I janë tretur kockat atje, në dhe të huaj. Bëri, ç'bëri, çau e ndau Sejfi e gjeti nusen. Sejfulla e ka emrin burri im, po i flasim Sejfi. E kishte detyrim. Borxh. Pjesën e tij të pasurisë nga babai, dhëndri na e la neve. Na dërgoi deklaratën. Merreni! Ta gëzoni, na shkroi. Keni vuajtur. E meritoni! Po dhe Sejfi ia shpërbleu. I gjeti nuse për kokë të nuses...

Sazet ia kishin shkukur një avazi që të këpuste shpirtin. Dhëndri, një zijosh jo dhe aq i freskët, me kostum blu, këmishë të bardhë e papion rrinte në krye. Tymoste puro. Në njërin krah i rrinte nusja. Si kukull. Shumë e re dhe fare pa përvojë në dukje. E vogël fare. Sikur ishte futur e tëra në fustan të bardhë. Në krahun tjetër rrinte nëna e tij, grua thatime, në moshë të thellë pleqërie. Dy këngëtarët, njëri që ia merrte dhe tjetri që ia priste, nga gryka nuk rridhnin avaze, por mjaltë. Diku dëgjoheshin vargje që drithëronin:

“Çupëz e Përmetit sytë ç't'i vërtita,  
i ziu ç'më gjeti, se në Vjosë u mbyta...”

Tundeshin trarët, dyert, dritaret e larta. Shishet me raki e qelqet me verë zbrazeshin e mbusheshin pandërprerë. Verë dhe raki Përmeti! Për kokë të tyre!

- Pi pa merak, gazetar! - i mbushi gotën Sejfiu, pronari i hotelit. - Kjo verë është gjak Krishti! E kemi tonën. Të pastër, kristal... Kam dhe raki rrushi, mani, dëllinje... Fol, ç'do?

- E di, e di... - nuk përfundoi dot fjalën Bojkeni.

- Rroftë demokracia që na ktheu pronën!

Ëndrra e ringjalljes e kishte rinuar e gjallëruar atë burrë.

- Kam marrë pjesë të vreshtave rrotull kodrave sipër. I punoj vetë, me përmetarë. Po dhe i paguaj mirë...

- Mirë bën...

- Këtu askush nuk mërzhitet me punën. Ia dinë anën. Gratë bëjnë glikotë e arrave me farë bajamesh dhe me kumbullën gërquinje. Kemi bërë zahiretë e dimrit, domate e pastërma, vargje me stafidhe e vadhëza. Plot i kemi sepetet në pat. Po ne burrat i kemi më të bekuara punët. Lëre se ç'hare është të vjelësh rrushin e të ziesh rakinë. Nuk tregohet dot! Rrjedhin ditët vetëm për kazanët e mëdhenj që ziejnë lëngun e bekuar. Në dimër të ngroh frymën e shpirtin. Vreshtat e Bolëngës janë mbushur me rrush erëmirë. Vreshtat janë aty, pak metra mbi varreza.

Pesë çupëza Përmeti po kërcenin dhe Keti Braumfisher ishte në vallen e tyre. Mrekullohej me misterin. Hareja e atyshme ishte si e përjetshme. Këngëtari shkrihej me sazet si gurgullimë kapriçoze burimi që kërcen nëpër gurët e lëmuar dhe klithte ëmbël:

“Poshtë, moj nga çairët - ë...!”

Kur muzika pushoi për të marrë pak frymë, trashaluoja e zuri Ketin për dore dhe i tha:

- Eja, të të tregoj ca gjëra!

Dhe nuk priti. U nisën. Të dyja. Hynë në kthinën e parë majtas, në kat të tretë.

- Eja, eja moj, hyr, ç'pret! Këtu kemi pajën e nuses. E sollëm në mëngjes. U shkul Përmeti gjithë. Ja, shikoji!

Dhe i tregoi kanistrat me petkat e reja, këpucë, veshje, shtroje, mbulesa, dhurata, pajën shumëvjeçare, kutinë e nuses me gjithë takëmet e tualetit, që nga pasqyra, rripi i mesit, krehri, buzëkuqi...

- U zien qiqrat dhe unë e dhëndri shkuam në mëngjes për të marrë nusen. Pastaj erdhëm këtu në vilë. Me kaloshinë. Yja...yja...! Dy kuaj të zinj. Karrocieri ishte djalë i ri. Ta pije në kupë, ta pije! Këtu në vilë i kisha lënë të gjitha gati, glikotë e pijet, orizin, kupën e mjaltit... Zbritëm me nge nga kaloshina, dhëndri me nusen i folën: "Hap portën, baba!" Portën e hapi Sejfiu im. Nuses i prunë kulaç ta ngjëronte me vjehrrën. Vjehrra i leu gishtërinjtë me mjaltë, pastaj bashkë e ngritëm nusen hopa të lyente ballin e portës...

Dy gratë, trashalujka dhe Keti dukeshin si mike të vjetra. Hiri i kënaqësisë e shtynte trashalujen të fliste pa pushim, ndërsa Keti, që s'po kuptonte shumë ç'thoshte, ndiente dhimbje të tmerrshme koke.

Sejfiu u kthye në tavolinë, kësaj here i s'këlldisur.

- Atje, sekush qëlloi me gurë portën e jashtme. Ishin djem të vegjël. U nxora ushqim, fruta, stafidhe e fiq çepedha. Po nuk donin asgjë nga këto. U larguan. Duket i mëson ndonjë i rritur... Ej, drejt! Ç'nuk ndodh në këto kohë!

Mendja e Sejfiut mbeti te porta e jashtme. Bënte, ç'bënte e kthente kokën andej.

- O, jo kështu! S'ke marrë asgjë! Provo pak pulë me arra e kukurec! - i tërhoqi vërejtjen Bojkenit, duke i vënë copa të plota në pjatë. - E kam merak këtë dasmë, amanet nga vëllai që më tretet në dhe të huaj... Dua gaz e lumturi për të gjithë.

- Po shkon si jo më mirë, - tha Bojkeni shkurt, i bindur se tjetri e kishte marrë pohimin si shprehje të hapur miqësie.

- Ashtu, or mik, ashtu!

Sejfiu donte të shkrehej.

- E kam nisur herët dasmën. E di ti? E nisa në dymbëdhjetë të natës, me gjyma e bucela. Mbusha ujë në çezmën e madhe të Janakos. Ujë të bekuar. Bashkë me krushqit. Pastaj shkova në mulli e blova drithërat. Me ujin e bekuar gatuam miellin për bukë, zumë qiqrën. Dhëndri e nusja prenë ujin pranë burimit dhe larguan syrin e keq. Në shtëpi lyen duart me miell. Erdhi brumi. Me ujë të bekuar u rruajt dhe dhëndri. E vështa sipas zakonit. I bëra të gjitha si duhet, sipas porosive të Perëndisë. Dhe ja, tani është koha të gëzojmë!

- U lutëm sa erdhëm!

Bojken Kostanit i ngjau sikur ai burrë sapo kishte ardhur nga udha e ujqërve. Ç'zë të fortë kishte, sa energji vërshonte në damarët e tij!

- Nuk e di, po kënaqet mikja jote? - i shkeli syrin çapkënçe.

- E papritur ftesa e dasmës...

- Kur m'u arratis vëllai, dyzet e kusur vite në Greqi e më pas në Australi, m'u përmbys bota. Thashë nuk kam më jetë! Po ja ku jam! Ku ka frymë ka dhe shpresë...

- S'të kam falënderuar...

- Portën time do ta gjesh gjithnjë hapur. Eja më tako sa herë të vish në Përmet!

- Rrofsh!

\* \* \*

Keti Braumfisher, përgjumësh, u fut në krahët e Bojken Kostanit dhe qëndroi gjatë duke psherëtirë herë-herë

qetësisht. Ishte dita e dytë në atë hotel. S'kishte gjumë. Këmbët e ftohta i ngrohte duke i pleksur me këmbët e Bojkenit, gjersa ndizej si furrë që pjek bukën... Më pas ndiente sesi hapej ngadalë, duke tërhequr thellë brenda vetes gjithçka të tij. Fillimisht zjarr, pastaj ngrohtë e më tej ëmbël, mjaltë, si ato avazet e sazeve të dasmës. Në fund rënkimet, si ftesa për të nisur nga e para...

Ama, e kishin pikëlluar sytë e nuses në dasmë! Pa ngjyrë. Sy të verbre! Dhe ai dhëndri që rrinte si dru... Ja, kështu mendonte. Rregullonte frymëmarrjen për t'u dhënë kohën e duhur mendimeve të ngatërruara që donte t'i sistemonte sipas rendit që kishte qejf.

- Ty t'u duk e lumtur nusja?

Ishin psherëtima të pakuptueshme, që nuk do të pushonin, si të ruajtura enkas për t'u zbrazur aty, në atë orë mesnate, në hotelin modest anës lumit me emër dymijëvjeçar.

- Me siguri diçka do të ketë pasur...

- Mua m'u duk e vdekur...

- Ashtu? Përse?

- Nuk qeshi një herë, as u ngrit në kërcim, as...

- Nuk e di. Thonë që dhëndri është shumë xheloz. E ruan. Apo...

- Nuk shkonin me njëri-tjetrin... - pëshpëriti ftohtësisht diçka nga dyshimi. - Ajo ishte tjetër.

- Si tjetër?

- Tjetër nga ai. E vogël. Mbase me miq të moshës...

- Mundet ose ndoshta...

- Çfarë?

- Lëre fare, kot...

Vjosa rrëshqiste e qetë në shtratin që kishte zgjedhur e përshtatur prej qindra vjetësh. Rrinin të dy në dritare duke përplasur kohë pas kohe frymën e shqetësuar në xham.

Përmeti ishte bymyer rëndë natën pas shirave të rrëmbyera që ranë papritur.

“Ky është çasti kur gjumashëve u hapen zavalle,\* (TELASHE, SHQETËSIME) - thoshte Sejfu, - të mençurit nuk i besojnë alibitë e disfatës dhe e mbajnë fshehur dhimbjen si thesar të groposur, ndërsa të ngeshmit gogësinë.”

Keti Braumfisher, që nuk po shqitej nga krahët e tij, ende nuk po i ndalte psherëtimat që i gufonin gjoksit të vogël.

“Janë si dardhë mali”, i pëshpëriste në vesh ai.

“Ashtu, ë?”

Gufmimet dukej se kërkonin shpjegime të hollësishme për ftohtësinë që tregoi atje, në katund’thin mbi male.

“Ah, kjo paska qenë arsyeja e qëndrimit akull? Mirë, të tregoj unë!”

Vërtet, Bojken Kostani atje në pyll, u përpi nga rrëfimet e plakut të çuditshëm që jetonte si eremit, sa në mal, sa në shtëpizën e vetmuar në Kamenckë. Askush nuk e dinte mirë me se merrej, me se ushqehet ai plak burrë që vdekja e kishte harruar me kohë. Kostandin Ballgjeri duhet t’i kishte nën lëkurë nja nëntëdhjetë vite të mira, por në trup e duar ishte i fortë si një dyzetyççar. Me kokë shogune, pa flokë dhe fytyrën si hartë rrudhash, ai ngjante i një bote tjetër.

Bojken Kostanit nuk i ikej nga pylli, në të vërtetë nga dëgjimi dhe fjalosja me dëshmitarin e legjendës së Shkëmbit të Nuseve dhe gjarprit të zi.

E shkëputi lehtë Ketin nga krahët, u tërhoq gjer te frigoriferi dhe nxori prej andej shishen me “Martini” që e

kishte sjellë me vete. Mbushi dy gota plastike dhe i zgjati një rën.

Ajo e mori pa dëshirë. Nuk ishte e urtë, as nga sekt i kërrusur i të dobëtave, por me mungesën e dëshirës deshi t'i përcjellë Bojkenit se kishte ende diçka të paqartë, të pakapshme, flu, të pakuptueshme në gjendjen e atyre që kishin ndodhur një ditë më parë. Me fjalë të tjera, a mund t'i thoshte ai se ç'ishte intervista me burrin misterioz atje, në pyllin e dendur në male? Përse gjithçka kaq sekrete, apo mos orët e lodhjes ia theksonin më shumë trazimet dhe ajo bënte pyetje naive? Pastaj telefonatat në recepsion pas thirrjes të sportelistit... Ç'ishin të gjitha këto?

Pa u ndrojtur kujtoi bisedën kur u nisën nga Tirana për në Jug.

“Do të shkojmë për dy ditë në Përmet. Ti e di mirë që i jam vënë pas një legjende”, i kishte thënë Bojkeni.

Atë “legjendë”, Keti Braumfisher mund ta zëvendësonte shumë mirë me fjalën “drenushë”. Bojken Kostani i ishte vënë pas një drenushe dhe ajo, mikesha fotografe po e ndihte ta shtinte në dorë. Po pse e shmangu duke i thënë: “Ti tani bëj fotografi peizazhi. Unë po vazhdoj me...”?

Në këtë rol i ngjau vetja si e përjashtuar. Mos e donte legjendën të tërën për vete? Fundja, legjendë nga vendi i tij ishte. Le ta merrte! Më tepër se legjenda, asaj i duhej harmonia, raporti me të. Bojkeni, herë me të qeshur e herë seriozisht e pickonte: “Vetëm në fillim të rrugës jemi bashkë. Gjatë ecjes pastaj, ndahemi”. Dhe nuk ishte fjala vetëm për gazetari apo punë redaksish. Qe diçka më e thellë, konceptuale, shpirtërore, mënyrë e përveçme e të parit të botës.

E menduar kësisoj edhe vetë u habit përse u tremb. Syri dhe veshi i mendjes së saj, si pjesa më e rrezikshme e njeriut, u frikësua nga ato që s'mund t'i perceptonte e kuptonte si duhej, tregimet, besimet, rrëfenjat, zakonet. Dhe kishte të drejtë. Ato i përkisnin një jete e një kulture tjetër.

- Vajzë e trishtuar me “Martini” në dorë, ku po e humbet mendjen?

Bojkeni donte të merrte gjithë vëmendjen e saj. Pavarësisht se dhe ajo donte të njëjtën gjë, nuk iu dhanë për herë të dytë njëri-tjetrit. Përkundrazi, bënë të kundërtën. Secili shkoi në këndin që dëshironte. Si dy të zemëruar, në këndin e vet të vetmisë. Dukej se pritej një sqarim. Vetmi, humbëtorë ishte edhe jashtë dritareve. Jashtë hotelit. Këmbë njeriu nëpër rrugë. Ata ishin në pritje të ditës së re. Pasioni, përtej dëshirës ndihej i fashitur, përgjumur. Pas mpirjes, me sa kuptohej, fizikisht kërkonin diçka më të thellë për t'u gjallëruar.

Bojkeni ndjeu se shkak i zemërimit të saj mund të ishte fakti që nuk i tha asgjë për intervistën me Kostandin Ballgjerin. E kishte ndier në dasmë. S'mund të mendonte që Keti ishte shpërfillëse. Në një mënyrë a një tjetër, ajo e dinte që refuzimi kishte kufi, një kufi që s'duhej kapërcyer asnjëherë. Ndryshe niste ftohtësia e padurueshme. Akullnaja. Si në një ngasje që ngjau nën shirat e papritur të asaj fundnate dimërore, shpresa për mirëkuptim paralajmëronte dhimbje. Kishin mbërritur në pikën ku kërkonin të mos ndaleshin te dallimet, por te grimcat e shpërndara të pasionit që duhej t'i mblidhnin me ndjeshmëri e kujdes.

- Sytë e tu kërkojnë falje më bukur se fjalët, - theu cipën e akullit Keti Braumfisher.

Nuk e duronte dot krisjen, me kurajën që ai të kuptonte se ajo jo vetëm nuk kishte humbur, por do t'i dëshmonte të kundërtën. T'i dëshmonte se ishte pranë tij dhe se çdo minutë që kalonte ishte një shans i humbur për të ndryshuar gjithçka në marrëdhënien e tyre. Vjen shpejt çasti kur segmenti i jetuar mirë pyet pjesën tjetër që pret në ankth: “Ç’je duke bërë?”

Krahët e saj ranë butësisht mbi supet e Bojken Kostanit dhe gjithë keqkuptimi sikur u thërrmua nën atë përqaftim dehës. Ajo fundnatë ishte errësirë, nuk kishte yje dhe dritat në Përmet ishin shuar krejt. Qielli kishte pushtuar agun. Ëndrrat ndoqën njëra-tjetrën.

Keti Braumfisher, futur në gjoksin e Bojkenit nuk kishte gjumë.

- Keqkuptimi ndodhi për fajin tim, - pëshpëriti. - Nuk dua të të humbas...

S’e mori vesh sa kohë ndenji ashtu, kruspullosur, gjersa trokiti dera. Sytë zhgabonjë të recepsionistin ishin gjak të kuq.

- Ju e patë taksinë rozë para hotelit?

Zëri kishte tingullin e fajtorit para ekzekutimit.

- Po. Ishte një taksi e tillë...

- E dija. E keni parë, kështu do të përgjigjeshit...

Duart e tij dridheshin.

- E...

- Ajo që sonte duhet ta vinte kokën në të njëjtin jastëk me dhëndrin...

- Ajo...

- Iku. Nusja ka ikur!

- Si ka ikur?

- As taksia rozë nuk është më aty...

- Domethënë... rrëmbim?

Keti Braumfisher nuk e përmbajti dot përndezen.

Pas kësaj “gjëme”, ai burrë vjetëran që pinte kokrra adalat çdo tetë orë, me siguri do të përpëlitej në grahmat e vdekjes. Lumi i jetës do ta merrte tani si një ashkël dhe kushedi ku do ta përplaste.

- I ziu unë që s’e ruajta dot! - zuri kokën me duar recepsionisti syzhgabonjë e mbylli lehtësisht derën.

Jashtë dita zbardhi me fytyrë gjithë vrima si të shpuara plumbash.

## KAPITULLI II

Rrugës në kthim, Ketu Braumfisher ishte e shqetësuar. Kishte kuptuar se vendi i të dashurit të saj nuk qenqesh vetëm romantik. Sa më tepër e mendonte, aq më i vështirë i dukej. E këputur nga pagjumi, nga rrahja e shpejtë e pulsit, ndoshta dhe nga historia e rrëmbimit të nuses, ndjeu mërzi të madhe, zbrazëti të frikshme.

Kur mbërritën në aeroport, befas, si të largonte një hije të keqe, ajo i tha:

- Ki kujdes! Ruaju vetë që të të mbrojë dhe Zoti!

Për habinë e saj, Bojkeni nuk foli fare. Ndoshta ato fjalë i ngjanë si paralajmërim lamtumire. Padurimi për t'i thënë pikërisht atë çast, nuk i pëlqeu. Turbullimi, përskuqja e faqeve, koka pak anash, mënyra si i tha, e prekën, e mpinë, por nuk e bënë shpërfillës.

Rrëmbëu bagazhet dhe eci për nga hyrja e terminalit. E kishte më të lehtë të mos fliste. Mbase ndarja, edhe pse s'e kishte menduar ndarje, ashtu si narkoza, po jepte efektin e saj. U ulën në stol. Për pak Ketu u ngrit të shkonte në sportel për të bërë *check-in*-et. Kaluan bagazhet te kontrolli. Përkundër natyrës së tij, gjithçka u krye në heshtje. Rrinin pa lëvizur, të shtyrë e të joshur, të lodhur e në ngasje, të pangopur e pengues, në mallëngjim e pezm, dyfish, trefish të dashuruar, por në tokë të paqëndrueshme, rrëshqitëse.

Ai e zuri për dore. Ajo që priste pikërisht atë gjest, iu fut në gjoks duke e përmbatur me stuhi puthjesh. Nëpër puthje ai sikur përfytyroi një peng, pengun që ajo e mbante pa thënë. Duke njohur xanxën, ajo mbase deshi t'i thoshte:

“Bojkeni im tani nuk është më si më parë. Ka dy legjenda për të zbuluar. Një të vjetër dhe një të re... Dua tekstin e tyre të zbërthyer. Mos do të ndërrojmë vendet?”

Nuk e tha pengun, ose nuk e kishte menduar fare ashtu si e përfytyronte Bojkeni. Koha e pritjes iku shpejt dhe ndarja ishte një përqafim i gjatë, i afshtë. Nuk prematuan asgjë. Tundje koke dhe sy.

Sy futur tërësisht te njëri-tjetri...

\* \* \*

Ishte i bindur që ikjen e Ketit do ta ndiente si mungesën e ajrit të pastër. Hamendjet kishin përfunduar. Preu djathtas “Jeep”-in la pas urën e shkatërruar dhe pa mbërritur te shkolla “Vasil Shanto”, vendosi të ndalojë te klub përkrah. Parkoi nga ana e pasme. Aty mjetin e ruante Xhelali, miku i tij dhe i familjes. Tre muaj më parë, ushtarakut të liruar para kohe i vdiq gruaja. Bashkë shkuan e morën të vdekur nga fshati për ta varrosur në Tiranë. Në varrim e sipër, te varrezat e Sharrës, mes gjithë atij pikëllimi kishte plasur edhe një shi që nuk do ta harronte kurrë.

Xhelali, i rrënuar nga braktisja, mërzia, hidhërimi qëndroi deri në fund të ceremonisë për të dëgjuar fjalitë dehëse të ngushëllimit. Po miqtë e të afërmit e pakët, në atë vaki ishin mumie, jo njerëz. Djali i madh e mbuloi nënën me baltën

e kuqërremtë dhe ia mbathi. Thanë se i nisej avioni për në Kanada. Vajza, fëmija i dytë, nuk mundi të vinte dot nga Anglia.

“Mëshirë”, kjo qe fjala më e kobshme për Xhelalin ato çaste. Ajo ndillte vetëm zi. Lajmëronte një gjëmë tjetër. Pas refuzimit të fëmijëve, ikjes, shpërfilljes, siç u mësua më pas nga një kureshti më e pikasur, fshihej zemërimi. Ata nuk e falën atin e tyre që shiti shtëpinë dhe paratë i futi te “Vefa”. As që e dërgoi nënën për të jetuar te prindërit e saj, në fshat, diku në rrethinat e Mirditës. Mëria e tyre ishte e gjatë. E lanë Xhelalin krejt të vetëm, në fatin e tij, pa strehë, fillikat e të pakrah, ndërkohë që gjendja po rëndohej.

- Gazetar!

Fytyra e burrit mjeran, Xhelal Karapici, dalë si pas një harrese të gjatë, u zgjat nga dritarja e klubit. Rrëmbimthi.

- Më ka humbur shkolla, gazetar... Mos e pe gjë? Ku ka ikur shejtania? Ku është? Ku ta gjej...

Ulur me shpinë nga shkolla, Xhelal Karapici, domethënë roja, burri që germën “Xh” e shqiptonte si një përzierje midis “zh”-së dhe “sh”-së, me gotën e rakisë në dorë, s’kishte si ta shihte shkollën. Përveçse i turbullt në shikim e në zë, ai ngjante cinik, i errët, i pashpresë. Shkolla ishte pas tij, përballë ekspozitës “Shqipëria sot”, në anën tjetër të Lanës. Mbi ekspozitë, pak vjet më parë ishte vitrina, një parullë e stërmadhe, me tri germa të rëna: “S qip r a sot.”

Ç’t’i thoshte Bojken Kostani, Xhelal Karapici? Përçartjet, shenjat e para të marrëzisë Xhelali i kishte shfaqur gati katër vjet më parë, kur e liruan nga ushtria. Priste gradimin e ëndërruar vite me radhë, kur ditën e parë

të nëntorit 1992, e liruan. Në listën vënë mbi xhamin e derës së jashtme të Ministrisë së Mbrojtjes, gjeti emrin e tij. Xhelal Karapici. Nuk u besoi syve. E kishin liruar nga detyra. Nuk do të ishte më kurrë ushtarak.

“Tani, tani që do të bëhesha gjeneral, më e pakta kolonel, tani e gjetën? Si mundën të ma bënëin këtë? Të më gradonin një herë, të paktën për një muaj, pa le të vdisja! Ku shkoi sakrifica ime? Ah, Safet, Safet - sifet! Ç’më bëre!” - mallkonte ministrin e Mbrojtjes.

Pritje e gjatë, zhgënjim i hidhur. Gjithë karriera tridhjetëvjeçare përfundoi në një kolibe rojesh. Një mik i vjetër e sistemoi në punën e re, rojë shkollë.

- Ha një copë bukë!

Sytë e mikut të picërruar tinës, larg çdo trazimi të dyshimtë, me kujdes vrastar nga vrasja e ndërgjegjes, sytë e mikut kërkuan që dhe sytë e Xhelal Karapicit të shihnin nga shkolla, vendi i ri i punës së tij. Vetëm kur sytë e tyre përfunduan të pajtuar, ai u largua duke e kthyer edhe një herë kokën pas, si për ta kujtuar:

“Është kohë tjetër, Xhelal! Kemi humbur!”

Goditja ballore ishte shmangur tinëzisht, me gjoja përkujdesje, për një tjetër më tinëzare, më poshtëruese. Jo më prishjen e karrierës ushtarake, po shpërfytyrimin e tij. Do të luftonte për bukën e gojës dhëmbë për dhëmbë, ashtu në fund, ku qe katandisur. Fytyra e dikurshme i ishte baltosur. Kërkimi i shkakut se përse, si edhe mosgjetja e tij, ia tërbonin krejt psikikën e lodhur ndër vitet e ushtarakut të bindur, besimtar në nderin e detyrës, i gatshëm për gjithçka.

Besonte se largimi i parakohshëm nga detyra ishte mister që lidhej ndoshta me shërbimin si ushtarak në kohën tjetër. Po ç'faj kishte ai? Ai besonte verbërisht se i shërbente atdheut, vetëm atdheut; maleve, fushave, kufijve shtetërorë... Atëherë kurrë nuk e vrau mendjen, nuk mendoi për gjëra të tjera, as të zhytej në mëdyshje të errëta që s'pranonin sqarim. Urdhëro - si urdhëron! Kjo ishte devizë e sjelljes së tij.

“Atëherë përse i lutej mbrëmjeve për shpjegim komshiut, Koço Kostanit? Përse?”

Koço Kostani, ekonomist nga ata që s'gjenden lehtë, një muaj para tij kishte pësuar të njëjtën histori. Gjetei emrin në listën e ngjitur në xham. Largim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Shporrje. Pa asnjë shpjegim. Ndryshe nga Xhelali, pas pamjes shpërfillëse, shqisat e Koços bënë kryengritje. Por Koçoja e dinte, përhapja e jehonës, e revoltës së shpërfytyrimit tek të tjerët, përveçse mund të mos dukej direkt si mospengim i shtetit, mund të ishte një nga ato kurthet e tij. Një nga ato kurthet që të tërhiqnin si pa u ndjerë në ingranazhet e blojës, hakmarrjes, dënimit, shuarjes përfundimtare.

Këtë nismëtim, qoftë dhe tërthorazi, u përpoq të ngulte në kokën e Xhelal Karapicit. Shija e parë ishte zhgënjimi. Koço Kostani nuk mundi të vazhdonte më tej, t'i shpjegonte në thellësi që shteti, nga natyra e mbrapshtë që ka, ndonjëherë përdorte të keqen për diçka që mendonte se nuk e bënte dot e mira.

Koço Kostani iku nga kjo botë pak muaj më vonë. E griu dëshpërimi. Trishtim pa fund. Mërzia e madhe.

Shpresëhumbur. Përmbysje. Kokëposhtë. Qyshkur e pabesueshme, ajo koha tjetër, ajo për të cilën nuk guxoi kurrë të fliste hapur, erdhi. Erdhi jo ashtu si e kishte përfytyruar. Erdhi ndryshe. Ndonëse prej disa vjetësh zemra i anonte nga koha e re, ajo erdhi zhgënjyese. E përdhosur që në djep. E mbytur në shpërgënj. E shqepur. E deformuar. Pa sens normal. E turbullt. Jobindëse.

Shenjat ishin të qarta. Me të njëjtën shpirtthyerje, mosvëmendje ndaj ngjarjeve të ditës, nisi të përcjellë çdo gjë më pas. Trazime të tilla ishin të përnatshme, në ballkon apo në dhomën e ndenjjes, në bisedat e gjata me Xhelal Karapicin, shoqëruar me kafe të hidhur, e ndonjëherë me pakëz raki në gota.

Si nisi, si mbaroi, a mbaroi vërtet?

U duk qartë se përhiorja e zyrtë e humbjes do të binte fillimisht mbi Koçon. Ishte i mosduhuri për kohën që jetonte. Xhelal Karapici do të ishte dëshmuesi i parë dhe pandehma ishte lehtësisht e qarkullueshme jo thjesht si thashethem. Nëse kërkohej një enigmë se përse, ishte pikërisht kjo, vetmia trazuese dhe plot dëshpërim e Koço Kostanit. Ai kishte vendosur të ikte përfundimisht, të ngjitej atje lart, tek engjëjt, në një ditë të pazakontë maji.

Dhe iku. E mbajti premtimin që i bëri vetes. Re të zeza mospranuese ishin mbledhur në qiell kur e nxorën arkivolin nga apartamenti. Kureshtja për atë ikje, si njehsim i kujdesshëm për çfarë ndodhte në atë pjesë të tokës, kishte zemëruar retë. Do të mjaftonte kjo për të krijuar tymësinë e frymës, të zërave të përzier në të vërteta të rrezikshme që bënë jehona e përhapnin si farë

në tokë të etur, shpirtin e revoltës. E vetmja gjë që dukej se kuptohej lehtësisht.

Xhelal Karapici kuptoi se prej asaj dite ishte plotësisht i humbur. I papërshtatshëm për asgjë. Nga ajo kohë ngjante si jo i kësaj bote. Rrinte gjithë ditën, sillej vërdallë në oborrin e shkollës. Punonte. Rregullonte. Por dhe pinte. Pinte te klubi përkrah shkollës. Te shkolla që pas gotës së pestë, thoshte se e kishte humbur. Sepse e kishte pas shpine dhe toka rrotullohej në labirintet e trurit të azdisur. Si shiti shtëpinë, rrinte tek e ndara në fund të murit të shkollës, ku qe sajuar një kthinëz e vogël për veglat e punës së bojaxhiut, lulishtarit dhe rojës. Ajo kolibe me dërrasa dhe eternite përsipër, u bë shtëpia e tij. Aty dergjej e flinte. Linte rrobat. Lahej dhe ushqehej. Kurrë nuk mori ndonjë shpjegim për padrejtësinë e lirimt që i kishte rënë mbi kokë. Sikur e harroi pak e pak.

“Reforma, reforma!”, i thanë kudo që shkoi.

Etja për lavdi, smira, egoizmi i papërmbajtshëm e tretën ngadalë, e vunë poshtë. Iu dorëzua pijes. Herë pas here Dhora, nëna e Bojkenit, i dërgonte në kolibe ndonjë pjatë gjellë.

Bojken Kostani e kishte pasur komshi Xhelalin, mik të babait, ndërsa djalin e tij, Ademin, shok shkollë. Xhelali binte kushëri me Dhorën, nënën e tij. Në shtëpinë e dikurshme të Xhelal Karapicit tani strehohej një tjetër familje, ardhur nga internimi. Nga Savra e Lushnjës thuhej.

- Xhelal, eja me mua. Fli nga ne sot. Këtu bën ftohtë. Eja me mua, ngjitemi lart në shtëpi, - e mori për krahësh Bojkeni.

Pagoi në banak dhe ikën. Duhej të bënte gati kronikën për edicionin e mbrëmjes.

Nxitonte...

\* \* \*

Vonë i telefonoi Ketii Braumfisherit në Gjermani. Kishte parandjenjë jo të mirë. Tëmthat i rëndonin. Me ç'dukej, gjithë lodhja e ditës peshonte aty.

Keti ishte vajzë jo aq e sofistikuar. Ishte njohur në korporatën mediatike shumëkombëshe. Nuk do ta harronte asnjëherë takimin e parë. Ajo e ftoi në apartamentin e saj, duke i thënë se do të pinin verë të bardhë dhe do të gatonte makarona me salcë, si ato që pëlqeheshin aq shumë në vendin e tij. Këtë e quante nderim.

Ai e pa i çuditur dhe më pas kuptoi që Keti Baumfisher nuk ia kishte idenë se ku binte atdheu i tij, Shqipëria. Ose ndoshta dinte afërsinë e saj me Italinë dhe mendonte se shqiptarët, për shkak të afërsisë gjeografike, kishin të njëjtat shije me italianët. Në takimet e mëvonshme ia kujtonte shpesh këtë gafë.

Kur Bojken Kostanin e dërguan në Shqipëri, reporter special e drejtues redaksie, Keti qau. Nuk donte t'i ikte. Më pas i premtoi se shumë shpejt do të ishte në Tiranë. Premtimin, si ngadhënjim mirësie, e bëri në katedralen e Këlnit. Gjithë ditën qëndruan bashkë. Brodhën në ura e parqe. Fotografuan dhjetëra objekte. Mbrëmjen e rezervuan në një motel ndanë lumit Rin, në Bon. Ishte fund shtatori, me erë të freskët, plot aroma lulesh e pemësh. Në verandën

e qelqtë zunë tavolinën që binte gati mbi Rin. Lumë i famshëm, me rreth një mijë e dyqind kilometra gjatësi, përshkon nëntë vende përpara se të derdhet në deltën Rhein - Maas - Schelde, në detin e Veriut.

- A e di, - përplaste e lumtur duart e vogla Ketit, pa e fshehur kërsërinë për të folurën e zhurmshme të të huajve në tavolinat përreth, - Rini është ndër rrugët më të pasura ujore të botës.

- Jo, vetëm kaq, - e treti Bojkeni entuziazmin e saj. - Viktor Hygo në vitin 1838, shkroi: "Gjithë historia e Europës është në këtë lumë".

Keti ia njihte pasionin për t'u endur në labirintet e historisë. Ndihej e mekur nga ndjesia e ikjes së kohës së çmuar për të bërë pa fund dashuri. Deshi ta devijonte bisedën. Por ai nuk e ndërpreu ngasjen.

- Rrjedha e lumit ka qenë gjithmonë një kordon lidhës për promovimin e mallrave dhe ideve në të gjithë Europën. Rini u shfaq edhe si një linjë kufiri ushtarak i romakëve, mes Francës e Gjermanisë, pas paqes së Vestfalisë, më 1648. Më pas lumi tregon historinë e industrializimit të Europës Qendrore. Në shekullin e 19-të, arti i piktorëve, i poetëve e këngëtarëve, kushtuar lumit e shndërruan atë në romantikën europiane...

- Mjaft! - dhe i vuri dorën e vogël te buzët.

Mendja e saj gjithë kohën rrinte te shtrati i motelit. Kishte ndjesinë se po humbiste vazhdimisht kohë.

E rrëmbeu për dore dhe hynë brenda. Ndryshe nga herët e tjera, bënë dashuri sa u shqepën, nuk thanë asgjë nga sa biseduan pa mbyllur gojë në verandë. Bojkeni mundi t'i thotë vetëm se ishte ende i magjepsur pas miteve e legjendave,

ndërsa ajo i tha se dashuronte marrëzisht udhëtimet. Pastaj, në ngut, si të kishte frikë nga diçka e panjohur, i pëshpëriti:

- Thonë që seksi e prish miqësinë. Është e vërtetë? Mos po kërkojmë diçka që s'është reale?

Bojkeni mbeti një copë herë me fytyrë të zymtë nga pasiguria, dyshimet, pyetjet, zhbirimet e tjetrës. Si e kishte kapërcyer aq lehtësisht gjendjen e dehjes seksuale për t'i bërë pyetje që zakonisht i bënte një mendje e ftohtë, racionale?

E vështroi gati me habi, ndjeu frikën e një të huaji, jo nga tjetra, por nga e vërteta.

- Di ndonjë gjë të përsosur? - pyeti më shumë veten, se Keti Braumfisherin.

Letrën e fundit të saj e kishte të gjithën në arkivin e mendjes. Tetëdhjetë fjalë, dymbëdhjetë rreshta, shtatë kryeradhë, katërbëdhjetë pikëçuditje e nëntë pikëpyetje. Ai tekst zbërthente thirrjen e brendshme të saj, lutjen, dëshirën për pëlqim, mjegullën që përpiquej të mbulonte të çarat e holla që shfaqeshin aty-këtu. Ia përlligjte njëfarësoj ankthin, mungesën dhe kohën që po zgjatej si një gjarpër i zi. “Gjë e zgjatur gjatë e gjatë bëhet gjarpër”, thuhej në vendin e saj.

Por, siç ndodh më së shumti me bisedat e largëta telefonike, shfaqet gjithnjë një hon moskuptimi, që krijon më pas vegjën e endjes së keqkuptimeve të tjera. Iu duk se ajo fillimisht foli ngadalë, me dëshirën e fshehtë që ai t'i merrte vesh gjysma-gjysma fjalët që thoshte, për ta bërë më të pakuptueshëm lajmin se ajo nuk do të vinte, siç kishte premtuar, në mes të janarit. Pyetjes “përse” nuk iu

përgjigj. Foli ashtu, si në mpirje, e shpërqendruar, për diçka të papritur, një projekt të rëndësishëm ku ishte përfshirë... Tha se donte që dhe ai të mund të ishte ndonjëherë atje, pranë saj.

Turbull, nga qindra kilometra larg, Bojken Kostani përpiquej të kapte diçka në zërin, në fjalët e saj, diçka që bëhej e pamundur dhe që i shpëtonte. Ishte, me sa dukej, një qasje ndryshe dhe femërore, që vinte nga një zonë tjetër e kontinentit. Ishin bërë luftëra pa fund, ishin përmbysur rende shoqërore, katedrale, gijotina, dekrete shtetesh, zakone e literaturë shkollore që ato të fitonin pavarësinë e dëshirave të tyre. Imponimi ishte i pamundur.

Fjalja e fundit që mundi t'i thotë në atë bisedë të paqartë, më tepër pështjelloi sesa sqaroi:

- Ti nuk do të vish dhe unë duhet të rri në pritje të telefonatës së radhës?

Pa i kthyer përgjigje, ajo përshëndeti me zë të akullt dhe mbylli telefonin.

Bojken Kostani nuk mbylli dot sy gjithë natën. Aty ndaj në të gdhirë, mbase në ëndërr, u ndje ca i lehtësuar, sepse besoi që gjeti në gurin e pragut vijën ndarëse me harrimin.

“Ky duhet të jetë kushti për të qenë njeri jetëgjatë që pendohej”, i tha vetes.

Guri si kambanë për t'u kujtuar se ishte ende gjallë, duke kënduar heshtazi një psalm.

“I lejohet gazetarit të këndojë një psalm? Unë jam gazetar, bëj një punë të mbushur me armiqësi e kundërshti. Dëshmoj të padëshmueshmen. Si ta braktis, të iki e të vij atje tek ti, moj Ketu Braumfisher? Njerëzit këtu në

vendin tim, sapo kanë filluar të dallojnë lajmin e vërtetë, nga dokrrat. Po e bëjnë më mirë dallimin mes botës - ëndërr dhe botës së vërtetë. Kam parë këto ditë rrugë të populluara me njerëz të dëshpëruar që kërkojnë shpresë, ushqim, karburant. Çdo ditë që vjen, më duket më gri se e mëparshmeja. Po dëgjoj një kabanë. Po aty ranë kabanat? Duket se po zgjohet qyteti. Këtu tani bie shi. Po andej nga ty? A u ngrit ajo mjegulla bezdisëse e Rinit? Bie shi. Shi në Tiranë. Shi dhe ylberë të ndritshme... Ja poezia që s'më lë të fle gjumë! Jam i lodhur dhe kam gjumë, Keti!

Bie shi, shi rebel, tërbon një kabanë,  
shi gjithandej, mërmërimë e mavijosur.  
Mërzi e vrer breth - përbindësh i gjallë,  
gulçon - bollë e plagosur..."

\* \* \*

Siç po i ndodhte shpesh ditët e fundit, zgjimi erdhi nga dritarja. Aty ulej një zog i çuditshëm, harabel a bishtatundës që mjaftohej me rrezet e pakta të diellit e disa kokrra gruri a thërrime buke që Bojken Kostani nuk harronte t'i linte në parvaz çdo mbrëmje. A zbriste nga ëndrrat ky zog, drejt e në dritaren e tij apo vinte nga diku tjetër, këtë nuk mund ta gjente dot. Shija e ëndrrës akoma të pafashitur, i nguli në kokë mendimin e parë të ditës. Ish-të dashurat sjellin gjithnjë ters!

"Ëndrra s't'i jep dot gjithë kënaqësitë e jetës", ngushëlloi veten dhe u ngrit me hov nga shtrati.

Në orën 10:00 kishte lënë takim pune. Një intervistë e sikletshme e priste. Me një bankier të njohur të Bankës Kombëtare. Fajdetë ua kishin vjedhur gjumin shqiptarëve. Asnjë kurë mjekësore, psikolog apo mjek psikiatër nuk mund t'i qetësonte dot ata. Nuk gjendej dot asnjë mundësi, qoftë edhe iluzive, për të shkarkuar një pjesë të stresit të tyre.

Me bankierin zgjodhën një vend larg syrit të njerëzve dhe kuriozëve. Do të flisnin për firmat rentiere dhe për rolin e shtetit. Nga gjithë të dhënat e javës së fundit, rezultonte se gremina po qasej me shpejtësi skëterre. Thuhej se shteti do të bllokonte llogaritë e fondacioneve bamirëse. A do ta bënte? Nën zë flitej që fondi prej 25,5 miliardë lekësh do të ngrinte në interes të qytetarëve. Shteti, gjithashtu, do të kishte edhe një komision transparence, që nuk do të lejonte të bëheshin transaksione hipotekare nga firmat që nuk likuidonin dot kreditorët. Ndërkaq, zëra të mistershëm, si përherë të nëndheshëm, pohonin faktin se vetëm javën e fundit, nga Shqipëria kishin dalë dhjetëra milionë dollarë. Kishin fluturuar në vendet e largëta, tej Atlantikut. Në ishujt *offshore*.

Ikja e parasë kombëtare do të thoshte vdekje klinike. Thashetheme, pandehma, lëvizje e kursit të përqindjes, mbyllja e sporteleve, sëmundjet misterioze të presidentëve të kompanive rentiere, çmendjet, ndarjet false, deklaratat e emisarëve perëndimorë, alarmi i FMN-së, pak e pak po e bënin shpërthyesë situatën. Kuptohej kërsëria për çfarë mund të thoshte bankieri, ndaj Bojken Kostani kishte xanxë padurimi.

U takuan në orën e përpiktë. Bankieri ishte burrë me sharm, tek të pesëdhjetat, me barseta të gjera e nofull katrore, kujdesur imtësisht për veten, me kollare të gjerë të kombi dhe këmishë “të qeses”, akull të bardhë, mbështjellë me xhakëtë plot kuadrate të vogla blu. Dukej nga e ecura që ia kishte dhuruar vetes, jetës që bënte, siguritë e duhura në pará.

- Stinë demonstratash, - tha dhe në buzët e trasha cinizmi iu përhap si krem i verdhë në një biftek kuqëran, të papjekur mirë. - “Duam paratë tona...” I ke dëgjuar?

- Po, sigurisht.

Bojken Kostani nuk e ndërpreu filozofimin e bankierit. Nga e folura krijoi përshtypjen se duhet të ishte jugor.

“Burrë karrierist në kryeqytet dhe baba i mirë në provincë. Ky është ekuacioni me këta tipa”, mendoi në çast.

Në tonin e tjetrit jo dhe aq miqësor, ndihej mëri e heshtur. Kundër kujt?

- Përmbysën varkën e shtetit dhe humbën gjithçka, - foli shpejt sikur ta kishte pickuar njeri në qafë. - Ka kuaj për shfaqje, ka edhe kuaj për punë. Por të gjithë kuajt mund të jetojnë në harmoni në grazhd. Jo kështu! E rrokullisën shtetin. Shteti nuk mund të jetë i cubave...

Papritur iu drejtua Bojken Kostanit, që po bënte gati mikrofonin dhe aparatën e incizimit:

- Të jemi të qartë për një gjë: dua anonimatat të plotë. Këto janë kohë të rrezikshme...

- E premtova këtë gjë, - i dha të drejtë frikës së tij Bojkeni, duke vijuar me pyetjet që kishte menduar.

- Çfarë po bën në këtë situatë Banka Kombëtare?

- Nuk po bëjmë gjë tjetër, vetëm po përpiqemi të shpëtojmë ato pak para që kanë ngelur në llogaritë e fondacioneve, kompanive rentiere. Në fakt, ky është vendim i vitit 1992, që deri tani nuk është zbatuar, por që do të fillojë nga zbatimi. Kjo është rruga e vetme për shmangien e rënies në greminë. Zbutja e katastrofës së fajdeve.

Gjuha e tij ishte e drunjte, e njëtrajtshme, pa asnjë emocion.

- Vetëm para tri ditësh ikën me det 130 milionë dollarë, - uli zërin bankieri, duke treguar dhe shkakun e nxitimit të Bankës Kombëtare në luftën kundër fajdeve. - Shifra e dalë me det është e barabartë me gjysmën e deficitit buxhetor të vitit të kaluar, që solli më parë rritjen e taksave, pastaj edhe të çmimeve...

- Si do t'i karakterizonit?

Bankieri nuk priti të mbaronte pyetjen Bojkeni. Me stil të rëndomtë, të vendosur, autoritar, që s'linte asnjë shteg interpretimi, deklaroi:

- Fajdetë shqiptare janë të gjitha piramida. Piramida të pastra. Sipas përllogaritjeve tona mbi depozitat e të gjitha kompanive që rentierët po tërheqin me shpejtësi nga bankat, firmat do të falimentojnë brenda javës së parë të shkurtit. Drejtuesit e këtyre firmave duhen të futen në burg për mashtrim, ndërsa pasuria e mbetur të dalë në ankand. Paratë e fituara nga shitja e pronave dhe ç'ka mbetur në llogaritë bankare, t'iu kthehen qytetarëve. Ata kanë abuzuar me kodin civil mbi huamarrjen.

- Po pronat, investimet e tyre...

- Fabrikat dhe kombinatet që pretendojnë janë fantazma. Ato ekzistojnë vetëm në halucinacione.

Bankieri nënqeshi dhe Bojkeni kuptoi që cinizmi i tij ishte shestuar jo pa shkak në krejt gjerësinë e fytyrës.

- Kërkesa e kompanive rentiere për një bankë të tyre? “Duam bankë”, bërtasin! I keni dëgjuar besoj?

- Ne nuk mund të japim licensën për një bankë që do të ishte antibankë!

Përgjigjja ishte e prerë, e thënë qetësisht, si të ishte e gatshme, shkullur pa dhimbje nga një rrafsh i shkretë.

- Pse nuk ka ndërhyrë deri tani Banka Kombëtare?

Ndonëse pyetje disi akuzuese, Bojkeni e dinte mirë që bankieri e priste atë.

- Me ligj jemi të pavarur nga shteti, - nisi gjithë qejf shpjegimin.

Atë “pavarësinë nga shteti” e tha me ndjesinë e heqjes së zhgunit nga shpatullat.

- Detyra jonë lidhet vetëm me monedhën, me kursin e këmbimit dhe inflacionin. Në momentin që konstatoam se këto dy pika nisën të çorientohen, nisëm ndërhyrjen. Banka Kombëtare po shpëton vendin nga një katastrofë ekonomike. Nëse do të lejonim të dilnin të gjitha paratë nga ne, qytetarët do të mbeteshin me xhepat bosh, - përmbylli me ton shpëtuesi përgjigjen.

- Pra, faji mbeti jetim...

Bojken Kostani e donte një konkluzion prej tij.

- Jo, jo. Faji nuk mbeti jetim. Faji është i qeverisë. Vetëm shteti e di të vërtetën e fajdeve, - përtypi fjalët dhe sikur deshi ta mbyllte bisedën bankieri.

- Si e di qeveria të vërtetën? - ngulmoi Bojkeni dhe e vështroi drejt e në sy, me shikimin që i thoshte: “Godit, bëj atë që duhet të bësh! Tani është koha!”.

- Qeveria, në fakt, Ministria e Financave, të bëjë publike tatimet e taksat e paguara nga firmat rentiere.

- E ç'del nga kjo?

- Duke parë tatimet e taksat e derdhura, shqiptarët e kuptojnë vetë si është gjendja e këtyre firmave, - nënqeshi bankieri.

Nga nofullat katrore, të shtrënguara si në morsetë, u duk sikur diçka e rëndësishme lëvizi, iku prej andej. Përfytyroi një burmë që e mbante shtrënguar, lirimi i së cilës derdhi lëndën.

- Në mirëbesim... - ndërhyri Bojken Kostani, - ju, personalisht, jeni kreditor, domethënë keni lënë para tuajat në këto kompani?

Nofullat katrore të bankierit u liruan plotësisht. Qeshi. Nëpër atë të qeshurën cinike rrëshqitën zbehtë djersë të holla, që herë ia zbulonin, herë ia linin në terr fytyrën e mbështjellë me maskë.

- Qeveria nuk e ka bërë detyrën, - u zhvendos ai nga rrezja e pamjes mbi të cilën ra një tjetër dritë që mund t'ia çirrte maskën, t'i tradhtonte gjithë ç'po thoshte.

- Banka Kombëtare e ka bërë detyrën, i ka kërkuar qeverisë një ligj për kontrollin e nivelit të interesave të fajdeve. Ende s'kemi një përgjigje. Presim...

Dëshmia e tij, ndonëse me ngjyrim të zbehtë të arrogancës që pjell paraja, hynte në dëshmitë që, ndonëse jo krejt e vërtetë, s'mund të quhej as e rreme. Një gazetari nuk i zihet besë asnjëherë.

Intervista e plotë u transmetua në edicionin e mesditës.

\* \* \*

Prag epidemie në kryeqytet. Shkreti anekënd. Numri i të sëmurëve në spitale mbahet sekret. Nëpër intervista mjekët flasin shkurt, me doza fataliteti. Nuk mund të ruhesh nga ky grip! Flitet se ishte kinez dhe ka hyrë nga kufiri juglindor, pra nga Maqedonia. Përhapja bëhet në rrugë aerogjene dhe njerëzit lëvizin shumë në kufirin mes dy vendeve. Ministria e Shëndetësisë dhe shteti duken të dorëzuar, sikur nuk kanë çfarë të bëjnë.

Nga një investigim rastësor, Bojkeni konstatoi se më tepër nga 45% e punonjësve të shtetit, janë me raport mjekësor në shtëpi. Ministria e Shëndetësisë, me zëdhënës, në një intervistë thotë se ende nuk ka marrë relacionet përfundimtare nga rrethet. Kjo heshtje është e ngjashme me heshtjen e poliomielitit rënë kohë më parë.

Në shtëpi, nëna e tij, Dhora, është me grip. Kushedi ku e ka marrë. Në treg, nga komshinjtë, ose ndoshta nga motra.

A është vërtet gripi kinez shkaku i mërzisë së madhe, i hutimit të përgjithshëm apo ndihet së largu zhurma, zhurma nga tërheqja zvarrë, pamundësia, dhimbja, lëngata që po afrohej nga humbja fatale e parave te firmat rentiere?

O Zot, ç'është ky ndëshkim?

### KAPITULLI III

Pse sytë e statujave janë gjithmonë pa jetë?

I dukej se përgjigja do të sillte edhe shpjegimin. Por nuk erdhi. Nga Ketu Braumfisher s'kishte asnjë lajm. Shenjë e keqe. Bardhësia e heshtjes ia shpoi sytë si me shtizë. Ëndërr e vërtetë, nuk është ajo që shikon kur je duke fjetur. Përkundrazi. Aktet madhore bëhen për hir të dashurisë ose të mbijetesës... Diku e kishte lexuar.

“Ku je tani, Ketu Braumfisher?”, gati thirri me piskamë.

Prej saj nuk po vinte asnjë shenjë. E pa në ëndërr. Kishte ardhur në Tiranë e po shëtisnin në bulevard, kur një shpend i stërmadh e rrëmbeu. Nuk ishte shqiponjë. As zgalem. Ishte gjë e zezë, pa formë të përcaktuar mirë, ose kështu i përhitej atij. Sa herë guxoi t'i sulej për ta ndalur, për ta trembur, për t'ia hequr Ketin nga kthetrat, ai bëhej më i parrokshëm, i jepte Ketit trazimin e dëshpërimit për burrin e pazot të mbronte femrën e tij. Ajo pafuqi nuk ngjante e kësaj bote. Sikur vinte nga një vend pa horizonte, pa limite, pa skaj. Nuk gjente pikë ku të ndalej, të orientohej, të rindizte pasionin e ftohur nëse ishte ai shkak, të gjente një adresë këmbysesish, negociatorësh, agjenti privat apo grupi që të merrte përsipër lirin.

Në atë tis misteri, si për shumëçka që rastiste për herë të parë, e ndiente se shpëtimi nuk do të vinte prej tyre,

sado të përpiqej t'i gjente, po prej ndonjë mrekullie që zakonisht lind nga thellësia e mërzhisë. Mendja njerëzore duket e paaftë të kapërcejë murin e kufizimit që e pengon të kuptojë si ndodh e gjitha kjo. Edhe midis përgjumjesh, ndodhnin çudi të pashpjegueshme. Si kjo flamë e paparë, por e dëgjuar, e frikshme dhe çorientuese. Mendja është magnet. Po mendove pozitivisht ajo tërheq pozitivitetin, po mendove negativisht ajo tërheq negativitetin.

Keti Braumfisher nuk ishte me të. Në cilën gjëmadhë të panjohur, të pangjashme me heshtjen strehohej shpirti i saj që nuk po e gjente dot? Ajo nuk i përgjigjej pozitivisht thirrjes së tij për të ardhur në Tiranë. Përse? Zëra që nëpër ëndërr vinin dhe i flisnin shtrajtshtëm, pa kurrfarë sensi e logjike, përpiqeshin t'i shpjegonin me fjalë të zhveshura karakterin e shumëfishtë të femrës, natyrën e paqëndrueshme për shkak të njohjes e besimit të pamjaftueshëm, traditës së provës së zjarrit.

Bojkeni e quajti të gjithën, gjethe të verdha vjeshtake të një ëndrre të marrë. Ai nuk ishte njeri që kishte frikë nga gremisjet. Përçmonte përuljen, lavdet e përshpirtjet mallëngjyese. E kishte rigjetur dashurinë e fotografes gjermane dhe kur mendoi se e kishte humbur. Ashtu, befas. Mos vallë ftesën për të ardhur në Tiranë e kishte bërë pa shumë kujdes? Pafytyrësisht? Duke e lënduar?

Asnjëherë nuk e mori vesh thelbin e së keqes. Ajo nuk ishte si çdo grua tjetër. Një herë i ngjante si mbrojtëse hyjnish, herën tjetër si grua e rrezikshme. Ku ishte ajo tani? Ajo duhej t'i jepte sqarim përfundimtar, t'i tregonte një adresë nga skaji tjetër i fillit që soste atje, në Bon.